

## ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Rishqyrtim të dt.27.08.2021 nga Grupi i Operatori Ekonomik, “PMC” Shpk nga Prishtina & N.SH.”KASTRIOTI” Ferizaj, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Furnizimi dhe montimi i serrave**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-4673-1-1-1, nxjerrë këtë:

### VENDIM

**Refuzohet e pa bazuar** - Kërkesa për Rishqyrtim të dt.27.08.2021,parashtruar nga Grupi i Operatori Ekonomik, “PMC” Shpk nga Prishtina & N.SH.”KASTRIOTI” Ferizaj, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Furnizimi dhe montimi i serrave**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-4673-1-1-1, Kundër Njoftimit të Vendimin të AK të datës 23.08.2021 të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.

**Vërtetohet;** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 23.08.2021, të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.

**AK - Ka pezulluar;** Aktivitetin e prokurimit me dt.31.08.2021 dhe publikuar për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**AK- Qëndron prapa,** Njoftimit për kontratë të Aktivitetit të Prokurimit sepse kemi vazhduar sipas LPP-ës dhe legjislacionit dytësor të Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetimi

Grupi i Operatori Ekonomik, “PMC” Shpk nga Prishtina & N.SH.”KASTRIOTI” Ferizaj, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Furnizimi dhe montimi i serrave**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-4673-1-1-1, Kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 23.08.2021, Pas analizimit të pretendimit ankimore, AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pa bazuar dhe se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë:

Më: 24.08.2021, ky grup operatorësh ka kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderit gjegjësisht në oferten e operatorit të rekomanduar për kontratë.

Më: 24.08.2021, po at ditë ju lejua qasja, dhe në fakt muarr ofertën e operatorit të rekomanduar për kontratë.

AK ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka ardhë në përfundim si në vijim:



Pas analizimit të pretendimeve ankimore AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim **është e pa bazuar.**

1. Operatori Ekonomik “Berisha Construction” në këtë tender (pra në tenderin aktual për të cilin është bërë njoftimi mbi vendimin e AK-ës) ka ofertuar si i vetëm dhe jo në grup me Operatorin Ekonomik të cilit ju ka ndërprerë Kontrata. Është e vërtet që Operatori Ekonomik “Berisha Construction” i cili është propozuar për Kontratë ka qen anëtar i konzerciumit me Operatorin Ekonomik të cilit ju ka shkëputur kontrata për të njëjtin aktivitet të prokurimit por qe nuk ka qen lider i grupit dhe është tërhequr nga konzerciumi pas nënshkrimit të kontratës. Po të ishte tërhequr gjatë fazës së tenderimit apo vlerësimit natyrisht që AK kishte vepruar në bazë të nenit 27.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Operatori Ekonomik “Berisha Construction” është tërhequr pas nënshkrimit të kontratës dhe i njëjti nuk ka qen deponues i sigurimit të ekzekutimit pra AK ka vepruar në pajtueshmëri të plotë me interpretimin e KRPP-ës të publikuar në ueb-faqen e KRPP-ës me datë 19.05.2021. Me një fjalë Operatori Ekonomik “Berisha Construction” kur është shkëputur kontrata nuk ka qenë më anëtar i konzerciumit dhe shkëputja e kontratës dhe konfiskimi i sigurimit të ekzekutimit ka ndodhur mes AK-ës dhe Liderit të grupit të kontratës.

Autoriteti Kontraktues sipas LPP-së nuk ka të drejtë ta eliminoj një Operator Ekonomik **Pa ndonjë Vendim të Gjykatës kompetente me të cilin është shpall fajtor Operatori Ekonomik, i njëjti nuk mund të konsiderohet i pa përshtatshëm për të marr pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e një kontrate.**

2. Sa i përket qasjes në dokumente të prokurimit AK ka vepruar gjithashtu në përputhje të plotë me interpretimin e KRPP-ës të publikuar në ueb-faqe e saj te pyetjet e shpeshta me Nr. 40 e cila e përkufizon palën e interesit vetëm nëse OE ka qen pjesëmarrës në at tender. Pra AK-ën nuk e lejon ligji të lejoj qasje një OE në dokumentet e Kontratës nëse i njëjti nuk ka qenë pjesëmarrës në at tender. Siç e dini edhe ju në tenderin paraparak për të cilin është shkëputur Kontrata ju nuk keni ofertuar fare.

Gjithashtu AK ka publikuar në ueb-faqe të e-prokurimit të gjitha dokumentet përfshirë kontratën, shkëputjen e saj dhe arsyet e shkëputjes.

3. AK ka veprua në pajtim me të gjitha dispozitat e LPP-ës dhe legjislacionit sekondar të prokurimit në fuqi duke propozuar OE-ën me çmim më të lirë.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ato që u than më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Nga se u cek më lartë në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/1-092, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në institucionet tjera kompetente.

Nr. 14-570/01-0075161/21  
Podujevë,  
31.08.2021



Menaxheri ZP

Rasim Fejza